




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-12830/24 datë: 22.05.2024



Npi – 01/178 datë: 29.05.2024

Duke u bazuar në nenet 12.2 shkronja (d), 14, dhe neni 17 shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Nenin 2 i Ligjit të Kosovës për Eksproprijim (Ligji i vjetër i Eksproprijimit sipas të cilit është dhënë prona komunale në shfrytëzim); Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008, Kuvendi, duke shqyrtuar propozimin e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi Nr.02/455 të datës 22.05.2024, si dhe Rekomandimin e MAPL-së Nr.020-256-10-2024 të datës 30.04.2024, në seancën e mbajtur më 29.05.2024 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN E BAZËS LIGJORE TË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES Npi-01/118 TË DATËS 28.03.2024

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e -V- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më 29.05.2024, me shumicën e votave miratoi vendimin për ndryshimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes me numër Npi-01/118 të datës 28.03.2024 për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të Ngastrës Kadastrale me numër P-72809093-02148-4. Zona Kadastrale – Shtime. Me sipërfaqe prej 2000m². Kualiteti - Mal i klasës së dytë. Evidentuar Pasuri Shoqërore e Komunës – Shfrytëzues NPKSH – "Higjiena" Komuna Shtime, ndryshimi është bërë te baza ligjore si vijon:

- (Duke u bazuar në nenet 12.2 shkronja (d), 14, dhe neni 17 shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Nenin 2 i Ligjit të Kosovës për Eksproprijim (Ligji i vjetër i Eksproprijimit sipas të cilit është dhënë prona komunale në shfrytëzim); Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008).

II

A r s y e t i m: Komuna e Shtimes me vendimin Nr.01/347/2 të datës 27.09.2002 i ka dhënë në shfrytëzim të përkohshëm NPKSH "Higjiena" – Shtime, (tani – KRM-"Pastërtia") sipërfaqen e tokës prej 2000m² në N.K. P-72809093-02148-4; Z.K –Shtime, për objektin e administratës e autoparkun. Duke marrë për bazë Marrëveshjen Nr.02/354 të datës 27.10.2022, të Ministrisë të Punëve të Brendshme (MPB) dhe Komunës së Shtimes për Bashkëfinancim dhe Realizim të Projektit "Ndërtimi i Objektit të Komunës së Shtimes" në vlerën totale 2.5 milion euro, të cilat janë buxhetuar në Buxhetin e Republikës së Kosovës, është paraqitur nevoja për sigurimin e lokacionit, meqenëse Komuna e Shtimes nuk posedon paluajtshmëri e cila i plotëson kushtet për ndërtimin e objektit të ri të administratës, atëherë, Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi i ka propozuar Kuvendit miratimin e vendimit, sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ndryshimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi-01/118 të datës 28.03.2024 është rekomanduar nga MAPL - Nr.020-256-10-2024 më datën 30.04.2024 për arsye se ka qenë e shkruar si vijon:

"Bazuar në nenet 12.2 shkronja (d), 14 dhe neni 17 shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Nenin 2 i Ligjit të Kosovës për Eksproprijim (Ligji i vjetër i Eksproprijimit sipas të cilit është dhënë prona komunale në shfrytëzim); Nenin 4 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme; Ligji Nr.03/L-205 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme; Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008".

III

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi Kuvendit
Adnan Ademi